

Tiranë më, 27.07.2023

Në lidhje me deklaratën e aplikantit Romeo Nazarko PF, Skualifikimi i aplikimit për mbështetje nga IPARD, AZHBR: Nuk plotësoi kriteret ligjore për të drejtën e përdorimit të tokës.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, (AZHBR) sqaron opinionin publik në lidhje me një shkrim të publikuar në disa media, për skualifikimin e aplikimit të subjektit Romeo Nazarko PF, për mbështetje nga programin IPARD II, Masa 1.

AZHBR shpreh keqardhje që nuk është pyetur për rastin në fjalë, informacion i cili do t'i shërbente transparencës së informimit të publikut.

Aplikanti nuk ka plotësuar kriteret e programit për pronësinë e tokës/përdorimin e tokës ku do kryejë investimin.

Bazuar në Udhëzuesin për Aplikantë <https://azhbr.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Udhezuesi-per-Aplikantet-Shqip-1.pdf>, paragrafi 2.2 Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë për të gjitha investimet në Masën 1:

(4) Aplikanti duhet të dëshmojë se ai/ ajo është pronar i tokës/ ndërtesës që ka të bëjë me investimin ose

(5) Aplikanti duhet të ketë të drejtën ta përdorë atë (tokë/ndërtesë) për një minimum prej 10 vitesh duke llogaritur nga data kur aplikimi është dorëzuar.

Kontrata e qirasë, pavarësisht komunikimeve nuk është paraqitur asnjëhere konform kërkesave të programit. Pra në kontratë qiraje, qiramarrës kanë qënë më shumë se një subjekt, ndërkohë që në aplikim për mbështetje me grant nga programi IPARD II ka qënë vetëm 1 subjekt.

Subjekti në fjalë ka ankimuar vendimin për refuzimin e aplikimit, në AZHBR, në MBZHR, dhe në platformën e Bashkeëqeverisjes, dhe në të gjitha rastet vendimi për refuzimin ka mbetur në fuqi, duke qënë se subjekti nuk ka paraqitur dokumentin e pronësisë, sipas kriterëve të përcaktuara, brenda afatit të përcaktuar në Udhëzuesin për Aplikantët e Programit IPARD II.

Aplikanti pas refuzimit të ankimimit të tij duhet të kishte ushtruar të drejtën për të ankimuar vendimin pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, brenda afateve ligjore ose të

denonconte rastin nëse kishte pretendime për korrupsion, në adresën e dedikuar për parregullsitë: raportoparregullsi@azhbr.gov.al.

Sa më lart, nga struktura zbatuese e Programit IPARD është respektuar procedura ligjore dhe nuk ka asnjë shkelje administrative.

Për trajtimin e pabarabartë të pretenduar nga aplikanti konfirmojmë se, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural nuk ka asnjë rast të ngjashëm të verifikuar dhe të trajtuar deri më sot.

AZHBR si një institucion i akredituar për administrimin e fondeve nga BE, është fokusuar në zhvillimin e një Bujqësie të qëndrueshme dhe diversifikimin e ekonomisë Rurale, nëpërmjet granteve që përftohen nga Buxheti i Shtetit, Bashkimi Evropian duke zbatuar me përpikmëri kriteret e vendosura nga BE për aplikantët.